[Printo]

[Google Translate]

VENDIM

Nr. 955, datë 16.10.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 289, DATË 17.5.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE/NDËRTIMEVE INFORMALE (ALUIZNI)", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 46 të ligjit nr. 9482, datë 16.2.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 289, datë 17.5.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. ALUIZNI ka Drejtorinë e Përgjithshme në Tiranë dhe nga një drejtori varësie në nivel qarku. Përjashtimisht, në qarkun e Tiranës ALUIZNI ka tri drejtori varësie.".

2. Kudo në vendim emërtimi "…Ministri i Punëve Publike dhe Transportit …" zëvendësohet me "…Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit…".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

Copyright 2015 - www.ligjet.org